



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/44/21

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. M.A, ndaj gjyqtares F.D, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 13.12.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. M.A, ndaj gjyqtares F.D, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për të parashtruar Kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate - Kryetarja e Gjykatës A.Sh R me datë 15. 11.2021 ka pranuar ankesën nga av. M.A, ndaj gjyqtares F.D, për shpërdorim të punëve të gjyqtarit në lidhje me procedurën e dhënies së urdhrit të ndalimit dhe arrestimit të palës së dënuar me gjobë.

Avokati M.A, në ankesën e parashtruar ka theksuar se përveç Aktgjykimi P.nr.5567/16 të datës 21.06.2019 nuk na është dorëzuar kurrfarë parashtrëse, aktvendim apo ndonjë shkresë tjetër nga gjykata. Përkundër kësaj, pala M.K., në ditën kritike me datë 04.11.2021 në vend të kalimin kufitar në Morinë, në prezencën e familjes, Policia e Kosovës, pa paralajmërim, pa prezantim të kurrfarë dokumenti, arrestohet dhe me forcë dërgohet në burg në PKDU të Dubravës. Gjithashtu është theksuar në ankesë se gjyqtarja pas Aktgjykimit nuk ka marr asnjë veprim tjetër në lidhje me ekzekutimin/përmbarrimin e pagesës së gjobës së shqiptuar në shumën prej treqind (300) eurove, pa kurrfarë procedure lëshon urdhër për arrestim policor dhe burgim të personit të gjobitur.

Në lidhje me pretendimet e theksuar në ankesë, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se, “Bazuar në kërkesën tuaj ju njoftojë, se siç shihet edhe nga ankesa e avokatit M A, si gjyqtare, me aktgjykimin

P.nr.5567/16 të datës 21.06.2019, i është shqiptuar dënim me gjobë. I njëjti i është ekspeduar palës, dhe i është lënë e drejta për ankesë në afat prej 15 ditësh, siç është përcaktuar me ligj. Këtu edhe ka përfunduar puna ime si gjyqtare e çështjes, në këtë çështje penale. Ndërsa, ekzekutimin e dënimit me gjobë, e bënë zyra e ekzekutimit të kësaj gjykate. Ju njoftoj se unë nuk kam asnjë kompetencë në ekzekutim të dënimit por as nuk kam lëshuar asnjë urdhëresë përkitazi me arrestimin apo ndalimin e këtij të pandehuri”.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të ankesës, dhe deklarimit të gjyqtares, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për shkelje disiplinore të gjyqtares Lendita Berisha.

Autoriteti i kësaj gjykate, bazuar në faktet, ka gjet se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore në veprimet e që ka marr gjyqtarja në këtë çështje penale. Aktgjykim P.nr.5567/16 të datës 21.06.2016 i është ekspeduar palës dhe pas kalimit të afatit prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit nga i autorizuari i palës nuk është parashtruar ankesë në këtë çështje penale dhe në dispozitiv të Aktgjykimit është përcaktuar që “Nëse revokohet dënimi me gjobë dhe i pandehuri, nuk mundet apo nuk do ta përmbush atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim.

Gjykata Themelore në Prishtinë në bazë të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve penale me datë 03.09.2021 ka dhënë Urdhëresë për paraqitjen në institucionin për mbajtje të dënimit ndaj të dënuarit M.K., dhe urdhërohet që me datën 11.10.2021 të paraqitet në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për mbajtje të dënimit me gjobë të shndërruar me burg.

Për shkak të mos zbatimit të Urdhëresës për paraqitjen në institucionin për mbajtje të dënimit gjykata me datë 27.10.2021 lëshon Urdhëresë për kërkimin, ndalimin, Arrestimin dhe Dërgimin e të dënuarit në Institutin për mbajtje të dënimit.

feruar procesverbalit të seancës përgatitore të datës 17.11.2021, lidhur me propozimin e autorizuarit të paditësve për ndryshimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv, gjykata me aktvendim ka refuzuar propozimin për ndryshimin e kërkesëpadisë në këtë aspekt dhe në të njëjtin aktvendim në pikën II ka përcaktuar: “arsyetimin lidhur me këtë vendim gjykata do ta jap në vendimin përfundimtar”. Në aktvendim e datës 17.11.2021 gjykata ka përcaktuar se çështja e refuzimit të propozimit të kërkesëpadisë në aspektin objektiv do ta arsyetoj në vendimin përfundimtarë. Andaj, në çështjen e marrjes së vendimeve nga gjyqtarja nuk përbën shkelje disiplinore, është bindje e lirë e gjyqtares për të vendosur çështjen, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Për çështjen e pretendimeve për mohimin e përdorimit të mjeteve juridike e cekur në paragrafin e katër (4) të arsytimit në njërin anë, ndërsa në anën tjetër në paragrafin e gjashtë (6) të të njëjtës ka theksuar, ...kundër aktvendimit të tillë për lejimin ose refuzimin e ndryshimit të padisë nuk lejohet ankesë e veçantë. Ndaj vendimit përfundimtar të kësaj gjykatës pala e pakënaqur, sipas autorizimit, ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike në instancën e gjykatës më të lartë.

Në bazë të fakteve për këto çështje dhe provave të shqyrtuar nga Autoriteti i kësaj gjykate, veprimet e gjyqtares nuk përbëjnë shkelje disiplinore, dhe nuk ka shkelje të dispozitave të nenit 5

të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve apo shkelje të Kodit të Etikes Profesional për Gjyqtarë.

Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me parashtesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar KGJK-së kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/43/21, më datë 06.12.2021

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë